

KËRKESË
Nr. 560/4, datë 1.12.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 794, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, ‘Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Tiranë–Elbasan’ (shtesa)’”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 439,450 (katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personin e prekur nga ky shpronësim për interes publik, për pasurinë e paluajtshme, pronë private, e cila do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasurinë e llojit “arë” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personi që preket nga ky projekt, i cili ka emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit në ARRSH, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 439,450 (katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR
I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LISTA PARAPRAKE E PRONARIT, PASURIA PRONË PRIVATE E TË CILIT PREKET NGA DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 794, DATË 22.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘TIRANË–ELBASAN’” (SHTESA)

Nr. rendor në VKM nr. 794/2015	Të dhënat për pronarin					Sip. shtesë për shpronës. (m ²)	Vlerësimet	Vlera (lek)	Totale (lek)	Shënime
	Emri i pronarit	zk	Nr. i pas.	Lloji i pasurisë	Sip. totale		Çmimi (lek/m ²)			
10	Hysni Halit Sherifi	1997	127	Arë	2,600	935	470	439,450	439,450	Konfirmim ASHK (Shpronësuar me VKM-në nr. 794, datë 22.9.2015. për sipërfaqen 1365 m ² . Referuar VKT-së nr. 57, datë 26.10.2017 dhe nr. 64/1, datë 7.6.2017, kërkohet për shpronësim sipërfaqja shtesë prej 935 m ² .)
Vlera totale paraprake						935		439,450	439,450	